



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

№: 3510/2

Projekt-Vendim - nr. 5

Për "Shpenzime varrimi"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe VKB-së nr.138 datë 29.12.2023, "Për miratimin e Buxhetit 2024", dhe ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", neni 6/b pika 2.

Duke marrë shkas nga gjendja e vështirë ekonomike e personit, z.Enver Avdia , ish banues në qytetin Maliq dhe duke parë kushtet në të cilat ndodhej dhe sipas verifikimet e kryera nga nga njësia administrative Libonik, ka qënë e nevojëshme ndërhyrja e bashkisë për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojëshme për ceremonine e varrimit.

Për këtë arsye i propozojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Të miratojë vlerën financiare për subjektin "Nertila Hametaj", me NIPT **L13807001Q**.

1. Shërbime Funerale për të ndjerin Enver Avdia	40.000 lekë
<b>Totali</b>	<b>40.000 lekë</b>

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2024, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	40.000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social-Ekonomike të familjes.


IV. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.

Konceptoi:  
Pergj.Sekt.Sherbimeve të Kujdesit Shoqëror  
Miratoi:Dr.Finances dhe Buxhetit  
Jurist:

O.Canellari  
E.Petriti  
A.Muka

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 23.08.2024

№ 13910/2

## Relacion

### Për "Shpenzime varrimi"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe VKB-së nr.138 datë 29.12.2023, "Për miratimin e Buxhetit 2024", dhe ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin public të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004, "Për shërbimin publik të varrimit", neni 6/b pika 2 e cila ngarkon me përgjegjësi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit njësinë e vetëqeverisjes vendore për personat banues të saj, të cilët nuk kanë asnjë familjar apo të afërm për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

### 1. Enver Avdia

Enver Avdia ish banues i Qytetit Maliq, ishte person i vetmuar, i divorcuar me një djalë i cili jetonte me ish bashkëshorten dhe ai nuk kishte pasur asnjë kontakt me të prej vitesh, ai jetonte dhe punonte në Greqi prej disa kohësh, pavarësisht gjendjes civile që kishte në Maliq ai kishte shumë kohë që nuk jetonte në këtë qytet dhe nuk kishte asnjë pronë apo banesë në këtë zonë. Në datën 12.06.2024 jemi njoftuar nga Spitali i Traumes Tiranë mbi rastin e z.Enver Avdia i cili është shtruar për shkak të komplikacioneve të shëndetit të tij në datën 04.06.2024. Menjëherë mbas shtrimit të afërmit e tij largohen. Ai qëndron i shtruar aty deri në stabilizimin e sitatës shëndetësore dhe më pas rikthehet ne banesën e të afërmeve të tij në Korçe. Në datën 26.06.2024 njoftohemi nga Spitali Rajonal Korçe që Z.Enver është shtruar aty në gjendje të rënduar ku dhe ndërron jetë disa ditë mbas shtrimit, duke qënë i vetmuar dhe në vështirësi ekonomike hartohet ky project-vendim me qëllim përballimin e shpenzimeve të varrimit të tij.

Konceptoi:  
Pergj.Sekt.Sherbimeve të Kujdesit Shoqëror

O.Canellari  
E.Petriti

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topciu

